

VENDIM
Nr.367, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS KASTRIOT TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Kastriot të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kastriot të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.719, datë 30.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kastriot të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kastriot për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-10	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
11-13	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDETIN PUBLIK.	NË PRONËSI
14-23	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
24-25	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
27-43 (VETËM TROJET E LIRA)	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE OSE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI.	NË PËRDORIM
27-43 (VETËM SHESHET)	INFRASTRUKTURË (SHESHE LULISHTË DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
44,45,47,48,50,51,53,54,56,57,59,60,61,63,64,66,67,69,70,72,73,75,76,78,79,81,	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM
46,49,52,55,58,62,65,68,7174,77,80,82	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE DHE KANALE TË TRETA).	NË PRONËSI
155-182	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK.	NË PRONËSI
183-193	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE.	NË PRONËSI